



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2020:167755  
KA.nr.500/22  
Datë: 07.10.2024  
Numri i dokumentit: 06347481

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kolegji ISPE”, me seli në Prishtinë, i përfaqësuar sipas autorizimit të fundit nga Avokat Arlind Jupolli kundër të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje referuar ai AKA), me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga S.B. për shkak të anulimit të Vendimit Nr. Ref: 146/20D të datës 11.02.2020 dhe Vendimi Nr. 2910/220 i datës 23.11.2020 i të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim-Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tutje KShC), pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesorë publik të mbajtur me datë 10.06.2024, 19.09.2024 dhe me datë 02.10.2024, më 07.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi paditësit “Kolegji ISPE”, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar të anulohet Vendimit Nr. Ref: 146/20D i datës 11.02.2020 dhe Vendimi Nr. 2910/220 i datës 23.11.2020 i të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, si e pabazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Me datë 01.12.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Kolegji ISPE me seli në Prishtinë, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.nr.2064/2020, kundër të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, me kërkesë për anulim të Vendimit Nr. Ref: 146/20D të datës 11.02.2020 të nxjerrë nga e paditura Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror i Cilësisë dhe Vendimi Nr. 2910/220 i datës 23.11.2020, i Komisionit të Ankesave të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, me propozim që të obligohet Këshilli Shtetëror i Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, që të nxjerr vendim me të cilin i aprovohet kërkesa Kolegjit ISPE dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Seinajokit (Finlandë)-tutje (SeAMK) për akreditim të programit të studimit në Infermieri Diplomë e Përbashkët.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 500/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor më datë 10.06.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit Avni Mazreku dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditur S.B., pastaj më datë 12.09.2024 dhe më datë 02.10.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditësit Avokat Arlind Jupolli sipas autorizimit të datës 14.06.2024 dhe të përfaqësuesit të palës së paditur S.B. sipas autorizimit të datës 07.06.2024.

#### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e tij në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesorë publik dhe ne fjalë përfundimtare ka deklaruar se paditësit Kolegji ISPE dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Seinajokit në Finlandë (tutje SeAMK) brenda afatit ligjor kanë parashtruar kërkesë për akreditim në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për Programin e Studimit Infermieri, Diplomë e përbashkët e ofruar midis kolegjit ISPE dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Seinajokit nga Finlanda. Këshilli Shtetëror i Cilësisë pran Agjencisë së Kosovës për akreditim me vendimin Nr. Ref. 146/20D të datës 11.02.2020, e ka refuzuar kërkesën e Kolegjit ISPE dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Seinajokit nga Finlanda për akreditim të programit të studimit Infermieri, Diplomë e Përbashkët e ofruar midis kolegjit ISPE dhe

Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Seinajokit nga Finlanda (SeAMK) me pretendimin e mos përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Akreditim me nr. 15/2018 të datës 28.09.2018 dhe Raportit të Vlerësimit nga ana e grupit të ekspertëve në përbërje të Prof. Dr. D.Z.-kryetare dhe Znj. D.G.-studente eksperte, të datës 03.12.2019 të kontraktuar nga ana e Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Gjithashtu aplikimit të Kolegjit ISPE i ishte bashkangjitur kopje e marrëveshjes në mes Kolegjit ISPE dhe atij SeAMK ku në pikën 5 të Letrës Përcjellëse të Aplikimit të Kolegjit ISPE ishte shprehur në mënyrë eksplicite aplikimi i përbashkët.

5. Ka shtuar se KShC me vendimin e atakuar me padi ka vepruar me lëshime esenciale duke mos vërtetuar se kërkesa për akreditim nuk ishte kërkesë vetëm e Kolegjit ISPE siç është potencuar në pikën (1) të vendimit të kundërshtuar, por ishte kërkesë për akreditim për Programin Diplomë e Përbashkët në Infermieri e ofruar midis Kolegjit ISPE dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Seinajokit nga Finlanda (SeAMK). Respektivisht në titullin e raportit vlerësues të Ekspertëve të Jashtëm lexohet se në faqen 4 pika 1.3 para. 3 si në vijim” *të dy institucionet bëhen partnere me qëllim që të ofrojnë një program për diplomë të përbashkët në Infermieri ashtu siç edhe paraqitet në kushtet e marrëveshjes të cilën e kanë nënshkruar të dy institucionet partnere*”, dhe i gjithë teksti i Raportit vlerësues i ekspertëve të jashtëm i referohet kërkesës së dy institucioneve partnere për programin Diplomë e Përbashkët në Infermieri, andaj ky veprim është kundërshtim me nenin 7 para. 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të lartë.
6. Sipas tij, në faqen 1 par.2 te pjesa e arsytimit të vendimit të kundërshtuar me padi është cituar si në vijim” *AKA ka organizuar vizitën e Akreditimit të Kolegjit ISPE më datë 25.10.2019 me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit me ekspert ndërkombëtar të akreditimit*”, ndërsa me këtë fakt vërtetohet se është shkelur dispozita ligjore e UA 15/2018 konkretisht afati ligjor brenda të cilit duhet të kryhet procesi i vlerësimit brenda të cilit do të duhej të ishte kryer procesi i vlerësimit të jashtëm, që nënkupton se vizita ishte organizuar pas fillimit të vitit akademik 2019/2020, ngase vizita vlerësuese nga ekipi i ekspertëve të jashtëm ishte organizuar më datë 25.10.2019 ndërsa ekspertët ndërkombëtar në raportin vlerësues konkretisht në faqe 33 në pjesën e tretë paraqesin shqetësimet lidhur me vonesat e shkaktuara gjatë procesit të vlerësimit dhe se ekspertët ndërkombëtarë ishin shumë të qartë në rekomandimet e tyre pozitive për vitin akademik

2020-2021, respektivisht në para. 1 në faqen 33 të Raportit përfundimtar të vlerësimit ku citohet se “ *se rekomandimi jonë është që të dy partnerët të marrin kohë deri në vitin e ardhshëm akademik (2020-2021) që të përgatiten për programin tërësisht në mënyrë që të japin kualitet të lartë dhe eksperiencë për studentët e ardhshëm, e që do ta bëjë secilin krenar*”, ndërsa e njëjta pjesë e raportit të ekspertëve është administruar si provë nga ana e Komisionit të Ankesave.

7. Prandaj marrë në konsideratë se vlerësimi i këtij programi kishte filluar me 25 (njëzet e pesë) ditë me vonesë nga fillimi i vitit akademik dhe raporti final vlerësues kishte përfunduar me 3 Dhjetor 2019, rrjedhimisht nuk mund të kishte akreditim retroaktiv për vitin akademik 2019-2020. Si pasojë e vonesave të dy partnerëve si Kolegji ISPE dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara nga Seinajoki i është pamundësuar e drejta për aplikim me këtë program për vitin akademik 2020- 2021 pasi që ky program në afatin ligjor 31 Tetor 2019 ishte në proces të vlerësimit nga AKA, andaj Komisioni i Ankesave do të duhej konstatuar se me këtë rast KSHC duke u vonuar në procesin e akreditimit i ka konsumuar afatet e parashtruesve të kërkesës në kundërshtim me nenin 11 para. 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018.
8. Përfundimisht ka deklaruar se konstatimi i vendimi i kundërshtuar me padë se “ekspertët kanë konstatuar se nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të manualit të akreditimit Kolegji ISPE për këtë program të studimit, dy (2) i plotëson substancialisht dhe pesë (5) pjesërisht, nuk është konform kualifikimeve të Raportit Vlerësues të ekspertëve pasi që pesë (5) nga shtatë (7) kapituj e Manualit të Akreditimit pjesa më e madhe e tyre ishte kualifikim si pjesërisht të përmbushur për vitin akademik 2019-2020 e jo për vitin 2020-2021. Në dokumentin e administruar si provë nga ana e Komisionit të Ankesave “Komentet në Draft Raportin e Ekipit të Ekspertëve të datës 24 Nëntor 2029”, shihet qartazi se si rezultat i neglizhencës dhe koordinimit jo të mirë nga ana e AKA-së këto komente nuk ishin të inkorporuar në raportin final të Ekipit të Ekspertëve të Jashtëm, ndërsa në këtë dokument shihet qartazi se Kolegji ISPE dhe Universiteti i Shkencave të Aplikuara kishin plotësuar standardet sipas Manualit për Akreditim në tërësi shtatë (7) nga shtatë (7) kapitujt e Manualit për Akreditim.
9. Sa i përket pjesës së arsytimit të vendimit të kundërshtuar Ref. 146/20D të datës 10.02.2020 lidhur me pretendimet për mos plotësimin e kriterëve nuk qëndrojnë dhe

cënimi i dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Nr.15/2018 janë prova të mjaftueshme se është zbatuar gabimisht ligji material.

10. Në seancën e datës 12.09.2024 përveç provave të bashkangjitura padisë kryesore paditësi ka propozuar që të dëgjohen disa dëshmitar të cilët sipas tij kanë njohuri përkatësisht kanë qenë pjesë e vendim marrjes dhe rekomandimeve me rastin e marrjes së vendimit të kundërligjshëm nga ana e të paditurës dhe atë: znj. D.Z., znj. D.G. të cilët veprojnë si eksperte për vlerësim të programit të kontraktuar nga e paditura mandej profesor H.A., anëtar i KSHC (bordi i të paditurës), z.D.Z.1. po ashtu anëtarë i KSHC, Z.A.G. ish drejtor i të paditurës, z. N.G. drejtor aktual i të paditurës, z. H.D. dhe M.Q. anëtarë të Komisionit të ankesave pranë të paditurës, këta në rrethana të vendosjes së kërkesës së paditëses, znj.H.K. përfaqësueses e Universitetit të SEINAJOK të Finlandës po ashtu znj. R.K. që të dyja në cilësinë e aplikuesit të përbashkët të paditësit, z. T.V. kryetar i konferencës së rektorëve të Finlandës si dhe të fundit shkëlqesinë e saj ambasadorën Pia Stjernëall në rrethana që e njëjta ka qenë e kontaktuar nga AKA e paditura në raport me aplikimin e paditësit.
11. Gjykata përmes aktvendimit në seancën gjyqësore e ka refuzuar propozimin e përfaqësuesit të paditësit për dëgjimin e dëshmitarëve sepse duke pas parasysh që raportet e vlerësimit dhe rekomandimet janë në paraqitura me shkrim, takimet janë të konstatuara ne procesverbale, procedura e komenteve është zhvilluar me shkrim, përfshirë vendimin dhe arsyetimi nuk është e nevojshme dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar për vlerësim të ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar.
12. Po ashtu paditësi përmes parashtresës së datës 30.09.2024 ka bërë propozim për zgjerimin e kërkesëpadisë duke kërkuar kompensimin e dëmit të shkaktuar në kuptim të fitimit të humbur dhe të dëmit real propozime të cilin gjykata e refuzoi përmes aktvendimit në seancë gjyqësore të datës 02.10.2024. Sepse propozimi për zgjerim të padisë nga paditësi u bë në procedurë të administrimit të provave, në kundërshtim me Nenin 258 të LPK-së, ku përcaktohet paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare.

13. Propozimin për marrjen e provës apo mendimin profesional nga Oda e Infermierëve të Kosovës, u refuzua përmes aktvendimit në seancë gjyqësore të datës 02.10.2024, sepse vlerësimi i përmbushjes së kushteve për akreditim bëhet nga organi kompetent vendimmarrës i autorizuar me ligj dhe jo nga organizata e pavarura të cilat te themeluara në cilësi të sindikatës për mbrojtje të interesave profesionale të anëtarëve të saj.

#### Kundërshtimet e të paditurës

14. Përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur S.B. në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesorë publik dhe në fjalën përfundimtare të dhënë më datë 09.10.2024 ka deklaruar se Agjencia e Kosovës për Akreditim e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit Kolegji ISPE si të pa bazuar pasi që paditës nuk ka arritur me asnjë fakt të argumentojë pretendimet e tij për anulimin e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (tutje KShC), Nr. Ref. 146/20D të datës 11.02.2020 lidhur me akreditimit për Infermieri BSc 180 ECTS.
15. Ka shtuar se, sa i përket pretendimit të paditësit se vendimi i kundërshtuar me padi është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, në pretendimin e paditësit KShC dhe Komisioni i Ankesave ka vepruar me lëshime esenciale duke mos vërtetuar se kërkesa për Akreditim nuk ishte kërkesë vetëm e Kolegjit ISPE siç paraqitet në pikën 1 të vendimit, sqaron se organet kolegjiale si KShC dhe Komisioni i Ankesave janë të thirrura që të shqyrtojnë përmbajtjen e raportit, procedurën dhe faktet me rendësi që ndërlidhen me plotësimin e kushteve, mos përmbajtja e Universitetit të Sinajokit në asnjë rast nuk mund të paraqet shkelje esenciale. AKA vendimet i ka marr bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtar ku në rastin konkret rekomandimi përfundimtar është negativ.
16. Ka deklaruar se sa i përket pretendimit të paditësit se AKA ka bërë organizimin e vizitës për akreditim në Kolegjin ISPE më datë 25.10.2019 në kundërshtim me UA 15/2018 konkretisht në kundërshtim me afatin ligjor brenda të cilit do të duhej të kryhet vlerësimi i jashtëm dhe vizita ishte organizuar pas fillimit të vitit akademik 2019/2020, nuk qëndron për faktin se duke u bazuar në nenin 11 të UA 15/2018 ku përcaktohet se AKA ka kohë një vitë për trajtimin e aplikacioneve prej datës së pranimit të kërkesës dhe se aplikacionet për akreditim duhet të dorëzohen në AK më së largu deri më 31 Tetor, ndërsa

AKA kishte organizuar vizitën brenda afatit ligjor, ndërsa në fjalën përfundimtare ka shtuar se AKA kishte organizuar vizitën brenda afatit ligjor duke sqaruar se pas krijimit të bazës ligjore për ri aplikim paditësi Kolegji ISPE kishte shfrytëzuar këtë të drejtë dhe më datë 03.07.2019 kishte parashtruar kërkesën për aplikim me nr. 1136/19H për akreditim/ri akreditim, e shumicës së programeve të cilat ishin refuzuar më parë. AKA kishte pranuar ri aplikimin e Kolegjit ISPE ndërsa më datë 25.09.2019 KShC kishte nxjerr vendim me nr. 1786/19D ku për programin Infermieri BSc 180 ECTS ishte aprovuar aplikacionin dhe paditësi ishte informuar nga AKA për vazhdimin e procesit të akreditimit sipas nenit 10 të UA për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Nr. 15/2018., ku më pas më datë 25.10.2019 që i bie se nga data e aplikimit deri ë data e vizitës janë më pak se katër ( 4) muaj dhe vendimi i KShC si organ vendimmarrës kishte ndodhur jo më vonë se gjashtë (6) apo shtatë (7) muaj.

17. Sa i përket pretendimit të paditësit për vlerësim jo të drejtë të raportit të ekspertëve ndërkombëtar nuk qëndron për faktin se sikurse KShC edhe Komisioni i Ankesave në arsyetimin e saj kanë konstatuar gjendjen faktike pasi që ka shqyrtuar raportin e ekspertëve ndërkombëtarë i cili nuk ka rekomanduar akreditimin e programit Infermieri, BSc 1820 ECTS të Kolegjit ISPE dhe ka vërtetuar se i njëjti gjithsej nga shtatë (7) kapituj të standardeve të parapara në manualin për akreditim (Korrik 2018) ky program përmbush substancialisht vetëm dy (2) standarde dhe pjesërisht pesë (5) standarde. Sa i përket pretendimit të paditësit se ekspertët ndërkombëtar kanë dhënë vlerësim për vitet tjera pasi që pesë (5) nga shtatë (7) kapituj e manualit të akreditimit pjesa më e madhe e tyre kishin kualifikim pjesërisht të përmbushur për vitin akademik 2019-2020 e jo për vitin 2020-2021, nuk qëndron nga fakti se vlerësimi nga ekspertët të bëhet për aplikacionin përkatës dhe për vitet përkatëse të përcaktuara në aplikacion.
18. Po ashtu në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi Kolegji ISPE kishte aplikuar për akreditimin e këtij programi edhe në vitin 2020 dhe KShC si organ kompetent i kishte refuzuar aplikacionin për akreditimin e këtij programi pasi që paditësi edhe më tutje nuk kishte arritur ti përmbush kriteret minimale të akreditimit që demanton pretendimin e paditësit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Kolegji ISPE, ndërsa të mbeten në fuqi vendimi i KShC Nr. Ref. 146/20D i datës 11.02.2020 dhe Vendimi i Komisionit të Ankesave në AKA Nr. 2909/20 i datës 23.11.2020.

## Provat e administruara

19. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova:

- Vendimi Nr.Ref:146/20D të datës 10.02.2020, Vendimi Nr.2910/20 i datës 23.11.2020, Letërpërcjellëse për ankesë nga kolegji ISPE për komisionin e ankesave të AKA-së me numër 311/20 me datë 08.09.2020 e bashkangjitur ankesa kundër vendimit 146/20, Marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të universiteti Senajokut dhe Kolegjit ISPE
- Raporti përfundimtar i vlerësimit të akreditimit nga ekipi i ekspertëve me datë 03.12.2019, Komentet e paditësit ISPE në draft raportin e ekipit të ekspertëve po ashtu të dorëzuara vetëm në gjuhën angleze, Komunikimi zyrtar përmes kolegjit ISPE me të paditurën me email me datë 08.08.2019, 18.08.2019, 19.09.2019, 25.09.2019, 09.09.2019, 16.09.2019, 14.10.2019 21.10.2019, 22.10.2019, 28.10.2019, 29.10.2019, 12.11.2019, 15.11.2019, 24.11.2019, 10.12.2019, 05.02.2020 (prova te papranueshme sepse dorëzohen vetëm në gjuhën angleze)
- Procesverbalin e takimit me datë 07.02.2020, Komunikimi zyrtar përmes kolegjit ISPE me të paditurën me email me datë 13.02.2020, 24.02.2020, 27.02.2020, 02.03.2020, Kërkesë për rishqyrtim nga kolegji ISPE për KSHC-në me numër 140/20 me datë 13.03.2020, Kërkesë për takim nga kolegji ISPE me datë 16.03.2020, Procesverbal i takimit me datë 14.04.2020, Certificate e auditimit nga Finneec me datës 14.04.2016 për Universiteti Senajok- Finland,
- Propozim vendimet për dy kolegjet nga M.Q. me datë 28.11.2020 dhe atë për kolegjin ISPE, Propozim vendimet për dy kolegjet me datë 26.11.2020 përfshirë edhe paditësit kolegjin ISPE, Letra e rektorit të Universitetit të Seinajok drejtuar bordit të AKA-s, Letra e Kryetarit të rektorëve të konferencës së Finlandës drejtuar MASHT dhe institucioneve relevante në shtetin e Kosovës në raport me aplikimin e paditësit, Komunikimet zyrtare përmes email me te paditurën të datave: 08.08.2019, 18.08.2019, 19.08.2019, 25.08.2019, Letra e Kryetari të Rektoreve te Fakulteteve Finlandeze te shkencave te aplikuara,
- Certifikata e Akredimit/Auditimit nga FINNEC me datë 14.04.2016 e dorëzuar ne përkthim në gjuhën shqipe, (mungon dokumenti origjinal), Shkresë e datës



06.03.2019 nga kryetari i rektorëve të universiteteve finlandeze të shkencave të aplikuara, aplikacioni i dorëzuar me datë 03.07.2019 i fotografuar nga libri i protokollit me nr.ref.1136/19, si dokument mbështetës i konstatimit në vendimin kundërshtuar lidhur me pranimin e aplikacionit.

20. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Për programin e studimeve infermieri për vitin 2019-2020 sipas marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të universiteti Senajokut dhe Kolegjit ISPE kanë aplikuar bashkërisht për diplomë të përbashkët. Raporti përfundimtar i vlerësimit të akreditimit nga ekipi i ekspertëve Prof, Dr. D.Z. dhe D.G. me datë 03.12.2019, konstatohet se programi Infermieri BSc 180 ECTS i ofruar bashkërisht nga kolegji ISPE dhe SeAMK Finland, është pjesërisht në përputhje me standardet e akreditimit, dhe rekomandon që të mos akreditohet programi i studimit dhe të mos pranohen student për vitin akademi 2019-2020. Komunikim rreth vlerësimit dhe akreditimit Kolegjit ISPE tani paditës është bërë përmes platformës Skype në mes të Kolegjit ISPE dhe Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Zyrtarit të Lartë për Vlerësim dhe Akreditim Agjencinë e Kosovës për Akreditim sipas Procesverbal i takimit me datë 14.04.2020. Në komentet e paditësit ISPE në draft raportin e ekipit të ekspertëve janë si konkludim konstatohet se paditësi i plotëson shumicën e standardeve të përcaktuara në manualin e akreditimit.
21. Agjencia e Kosovës për Akreditim-Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), me Vendimin Nr.Ref:146/20D të datës 10.02.2020, nuk ka akredituar programin e Kolegjit ISPE; Infermieri, BSc, 180 ECTS, me arsyetim se AKA ka organizuar vizitën e akreditimit në Kolegjin ISPE më datë 25.10.2019, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit në përbërje si: Prof. Dr. D.Z. dhe Znj. D.G.. KShC në mbledhjen e mbajtur më 16 dhe 17.01.2020 e ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit ISPE dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës dhe të rekomandimeve të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër ka vendosur si në dispozitiv të vendimit. Nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të Manualit të kreditimit Kolegji ISPE për këtë program të studimit plotëson dy (2) substancialisht dhe pesë (5) pjesërisht, dhe rrjedhimisht ka ndikuar në mosdhënien e akreditimit.
- Nga mangësitë e konstatuara nga ekspertët janë kapitulli i standardeve që ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë sepse nuk posedon politika dhe procese të qarta për sigurim

të cilësisë, pra një qasje që i mbulon të gjitha pjesët e programit edhe ato që zhvillohen në Finlandë dhe ato në Kosovë, por më një bazë të të dhënave të përbashkët në nivel të programit për ti shërbyer përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë. Ekspertët nuk kanë gjetur dëshmi se Kolegji ISPE posedon kapacitete për dizajnimin dhe zbatimin e një kalendari të tillë të vlerësimit, pavarësisht se në Raportin e Vetë Vlerësimit (tutje RVV) potencohet se kontrata e punës së stafit akademik dhe atij administrativ përcaktojnë vlerësimin e stafit dhe procesin e planifikimit për vlerësim periodik dhe përmirësim.

- Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me stafin akademik ekspertët kanë gjetur se pjesa më e madhe e stafit akademik janë të punësuar me orar të plotë dhe tre pjesëtar të stafit finlandez janë të dedikuar për programin në fjalë. Prej 34 mësimdhënësve të listuar për këtë program më shumë se 20 janë nga Finlanda për të cilët nuk është bërë e qartë se si do të përfshihen në mësimdhënie as mënyra e angazhimit të tyre dhe e njëjta gjë është dëshmuar edhe nga stafi gjatë vizitës së vlerësimit të cilët u shprehen se nuk ishin të informuar për detajet e angazhimit të tyre në mësimdhënie me studentë.
- Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me përmbajtjen e procesit edukativ ekspertët ndërkombëtar kanë vlerësuar se programi duhet të adaptohet në mënyrë që ti përshtatet kontekstit Kosovar. Syllabuset nuk bëjnë një ndarje të qartë në mes të ligjëratave dhe aktiviteteve aplikative si dhe nuk përmbajnë listën minimale të literaturës. Ekipi i ekspertëve nuk ka arritur që të gjejë evidencë të politikave dhe procedurave të cilat përfshijnë veprime që duhet të ndërmerren në rast të arritjeve të ulëta të studentëve.
- Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me hulumtimin, ekspertët vlerësues kanë konstatuar se Kolegji nuk ka caktuar objektiva për hulumtim shkencor. Në raportin e vetëvlerësimit thuhet se ISPE dhe SeAMK do të inkurajojnë dhe ndihmojnë stafin që të marrin pjesë në projekte kërkimore, mirëpo nuk ka asnjë evidencë se angazhimi i stafit të aktivitete kërkimore ndërlidhet me vlerësimin e stafit apo avancimin e tyre.
- Sa i përket kapitullit të standardeve që ka të bëjë me infrastrukturën dhe resurset ekspertët kanë konstatuar se objekti i marr me qera nga Kolegj ISPE ku është planifikuar të filloj programi nuk është në gjendje të akomodoj 80 studentë siç është kërkuar në aplikacion. Në kohën kur është zhvilluar vizita e ekspertëve vlerësues, është konstatuar se hapësirat e dedikuara për zhvillimin e programit nuk shinin të

përgatitura në mënyrë adekuate për fillimin e procesit të mësimdhënies dhe hulumtimeve shkencore.

- Andaj ekipi i ekspertëve ndërkombëtar nuk rekomandon fillimin e programit para se pajisjet dhe materialet e nevojshëm së paku për vitin e parë të studimeve të jenë të instaluar dhe të gatshme për punë. Sa i përket qasjes së personave me nevoja të veçanta objekti ku është planifikuar të ofrohet programi posedon një lift, mirëpo ekipi i ekspertëve gjatë vizitës nuk pati mundësi të shohë së di duhet objekti i ri ku planifikohet të bëhet programi pas një viti.

22. Kolegji ISPE ka paraqitur Kërkesë për rishqyrtim për KSHC-në me numër 140/20 më datë 13.03.2020, ndaj vendimit Ref.146/20D të datës 11.02.2020, me propozim që KSHC të nxjerr vendim për akreditimin e programit Diplomë e Përbashkët e ofruar nga Kolegji ISPE dhe Universiteti i Shkencave të aplikuara të Seinajokit nga Finlanda dhe programi të mund të filloj implementimin në vitit akademik 2020-2021. Nga Çertifikata e auditimit nga Finneç me datës 14.04.2016 Universiteti Seinajok- Finlandë konstatohet akreditimi i të njëjtit në kohëzgjatje për gjashtë (6) vite deri më 14.04.2022.

23. Komisioni i Ankesave në Agjencinë së Kosovës për Akreditim përmes Vendimit Nr.2910/20 të datës 23.11.2020, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e Kolegjit ISPE tani paditës me letrën përcjellëse 1495/20H të datës 08.09.2020 duke e vërtetuar vendimin e KShC-së me Nr. 146/20D i datës 11.02.2020 me arsyetim se bazuar në nenin 18 par. 2 të UA Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë i cili përcakton se “ Duke bazuar në rekomandimet nga raporti i vlerësuesve të jashtëm KShC merr vendim për akreditim ose mos akreditim”. Nga kjo vërehet se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore për përmbushjen e standardeve sipas Manualit të Akreditimit (Korrik 2018), i cili përcakton se “ Për të marr një vendim pozitiv për programin dhe ri-akreditimin institucional çdo ofruer i arsimit duhet të demonstroj të paktën një nivel të konsiderueshëm pajtueshmërie në gjykimin e përgjithshëm. Prandaj dështimi në përmbushjen e të paktën një niveli të përgjithshëm të pajtueshmërisë përfshinë votimin, tërheqjen, pezullimin ose mohimin e akreditimit”. Komisioni i Ankesave ka vlerësuar se përderisa KShC merr vendim bazuar në rekomandimet nga raporti i ekspertëve të jashtëm, atëherë vendimi 146/D i datës 11.02.2020 i KShC ka bazë ligjore dhe arsyeshmëri të plotë.

## Vlerësimi i Gjykatës

24. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.
25. Gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit kontestues lidhur me kompetencën e organit administrativ në kuptim të nenit 4 të LPPA, i cili përcakton kufizimin e organeve publike që veprimtarinë tyre ta realizojnë brenda kompetencave të tyre. Në par. 1 të këtij nenit është përcaktuar *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca*” dhe në përputhje me Nenin 7 dhe Nenin 18 të Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.
26. Gjykata vlerëson Vendimi i kundërshtuar Nr.Ref:146/20D i datës 10.02.2020, i marrë nga AKA me të cilin është refuzuar akreditimi i programit Kolegjit ISPE; Infermieri, BSc, 180 ECTS, dhe Vendimi i Komisioni i Ankesave në Agjencinë së Kosovës për Akreditim Nr.2910/20 të datës 23.11.2020, me të cilin e paditura e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e Kolegjit ISPE tani paditës me letrën përcjellëse 1495/20H të datës 08.09.2020 duke e vërtetuar vendimin e KShC-së me Nr. 146/20D i datës 11.02.2020, është marrë në pajtim me kompetencat ligjore të paditurës. Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni 7, *Agjencia e Kosovës për Akreditim AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë. Përmes proceseve profesionale dhe transparente të vlerësimit dhe kontrollit të cilësisë apo mjeteve të tjera që konsiderohen të përshtatshme nga ajo, të cilat i plotësojnë praktikën më të mira ndërkombëtare, ....Neni 15 përcakton Akreditimi dhe vlerësimi i cilësisë, 1.Të gjithë bartësit e licencuar të arsimit të lartë u nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë nga AKA-ja në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore...*

27. Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar është marrë në pajtim me rregullat procedurale dhe dispozitat ligjore, AKA ka organizuar vizitën e akreditimit në Kolegjin ISPE më datë 25.10.2019 me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit në përbërje si: Prof. Dr. D.Z. dhe Znj. D.G.. KShC në mbledhjen e mbajtur më 16 dhe 17.01.2020 e ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit ISPE dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës dhe të rekomandimeve të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët të cilët kanë konstatuar se programi Infermieri BSc 180 ECTS i ofruar bashkërisht nga kolegji ISPE dhe SeAMK Finland, është vetëm pjesërisht në përputhje me standardet e akreditimit, sepse nga gjithsej shtatë (7) kapituj të standardeve të Manualit të kreditimit Kolegji ISPE për këtë program të studimit plotëson dy (2) substancialisht dhe pesë (5) pjesërisht dhe ka rekomanduar që të mos akreditohet programi i studimit dhe të mos pranohen student për vitin akademi 2019-2020.
28. Neni 10 i Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr.15/2018, përcakton procedurën e akreditimit, ndërsa para.1 pika 1.2 thekson se: *Aprovimi i listave të stafit akademik. 1.2.1. Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës mbledhjen e ardhshme të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga Institucioni i Arsimit të Lartë, përgatitet nga stafi i AKA-së. Para 1 pika 1.5 parasheh se “AKA organizon procesin e vlerësimit të jashtëm me një ekip të pavarur të vlerësuesve ndërkombëtarë. Ky ekip harton një raport të jashtëm të vlerësimit i cili ofron një vlerësim të cilësisë së institucionit aplikues apo programeve të tij të studimit bazuar në standardet dhe udhëzuesit për akreditim. Ky raport i cili i dorëzohet AKA-së, ofron rekomandime për përmirësimin e cilësisë për IAL-të nën vlerësim si dhe përfshinë rekomandimin final për riakreditim apo mos akreditim. Para. 1 pika 1.6 parasheh se “KSHC vlerëson raportin e vlerësimit të jashtëm dhe vjen deri tek vendimi për akreditim. KSHC mund të jep akreditimin ose riakreditimin apo mund ta refuzoj atë.*

29. Gjykata vlerëson se e paditura vendimin për mos akreditim të programit e ka vlerësuar në raport të pavarur profesional të eksperteve të jashtë, në përputhje me udhëzimeve dhe standardet evropiane për cilësi në arsimin e lartë. Sepse në raportin e eksperteve janë konstatuara mangësi në kapitullin e standardeve që ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë, kapacitetet për dizajnimin dhe zbatimin e një kalendari të tillë të vlerësimit periodik dhe përmirësim, përbushjen e kapitullit të standardeve që ka të bëjë me stafin akademik ekspertët kanë gjetur prej 34 mësimdhënësve të listuar për këtë program më shumë se 20 janë nga Finlanda për të cilët nuk është bërë e qartë se si do të përfshihen në mësimdhënie as mënyra e angazhimit të tyre. Përbushjes se standardeve të kapitullit të standardeve që ka të bëjë me përmbytjen e procesit edukativ ekspertët ndërkombëtar që ti përshtatet kontekstit Kosovar. Syllabuset nuk bëjnë një ndarje të qartë në mes të ligjëratave dhe aktiviteteve aplikative si dhe nuk përmbajnë listën minimale të literaturës. Janë konstatuar mangësi të politikave dhe procedurave të cilat përfshijnë veprime që duhet të ndërmerren në rast të arritjeve të ulëta të studentëve, mangësi në kapitullin e standardeve që ka të bëjë me hulumtimin, ekspertët vlerësues sepse Kolegji nuk ka caktuar objektiva për hulumtim shkencor, standardeve që ka të bëjë me infrastrukturën dhe resurset ekspertët kanë konstatuar se objekti i marr me qera nga Kolegj ISPE ku është planifikuar të filloj programi nuk është në gjendje të akomodoj 80 studentë siç është kërkuar në aplikacion dhe nuk ishin të përgatitura në mënyrë adekuate për fillimin e procesit të mësimdhënies dhe hulumtimeve shkencore.
30. Sa i përket Propozim vendimit nga Prof. M.Q. në cilësi të anëtarit të Komisionit të Ankesave me të drejtë vote me datë 28.11.2020 dhe atë për kolegjin ISPE, *kishte propozuar që të aprovohet ankesa me nr. Protokolli 1495/20H e datës 08.09.2020 e parashtruar nga BPrAL Kolegji IPSE dhe ankesa me nr. protokolli 1496/20H e datës 08.09.2020 e parashtruar nga BPrAL Kolegji IPSE me arsyetim vendimet e anëtarëve të tjerë të përhershëm të komisionit si të pabazuara në fakte me arsyetim se nuk kanë dështuar të paraqesin gjendje faktike, gjykata e vlerëson si mendim mospajtues, dhe vlerëson se vendimmarrja nga e paditura është në përputhje me Nenin 4 të UA siç përcakton Strukturën Organizative të AKA-së paragrafi 1 parasheh se “AKA përbëhet nga: Këshilli Shtetëror i Cilësisë, ndërsa paragrafi 2.1 parasheh se “KSHC është organ politik bërës dhe vendimmarrës”, 2.3 parasheh se “KSHC merr vendim për akreditim me shumicë të votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet”.*

31. Sa i përket pretendimeve të paditësi se Vendim nuk reflekton saktë emërimi e titullarit te kërkesës se ka të bëjë më program të përbashkët të ISPE-se dhe SeAMK, gjykata e vlerëson se është i parëndësishëm për faktin se sipas raportin të vlerësimit të ekspertëve vlerësimi reflekton të gjeturat për programin e përbashkët të ISPE-se dhe SeAMK. Prandaj, edhe po të kthehej çështja për rivendosje për këtë arsye të emërimit formal nuk e ndryshon rezultatin e procesit të akreditimit.
32. Gjykata vlerësoj se provat e tjera të administruara si letra e rektorit të Universitetit të Seinajok drejtuar bordit të AKA-s, Letra e Kryetarit të rektorëve të konferencës së Finlandës drejtuar MASHT, Letra e Kryetarit të Rektoreve te fakulteteve finlandeze te shkencave te aplikuar e datës 06.03.2019 janë komunikime diplomatike në kuptim të bashkëpunimit shtetëror dhe nuk janë me ndikim ne vlerësimin e cilësisë së programit specifik të studimeve, prandaj si të tilla nuk janë më ndikim ne vlerësimi ndryshe te gjendjes faktike të konstatuar nga e paditura.
33. Prandaj si përfundim vlerëson se Vendimet e kundërshtuara janë nxjerrë brenda kompetencave ligjore si institucion kompetent për verifikimin e cilësisë së arsimit dhe akreditimin e bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe aktet administrative të kundërshtuara janë në përputhje Nenin 46 dhe 47 të LPPA-së, respektivisht me formën e aktit administrativ dhe strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ vlerëson se e paditura e ka vlerësuar drejt gjendjen faktike të konstatuar në vendim.
34. Andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Vendimi për shpenzimet procedurale u bazua në nenin 63 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

### Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative  
KA.nr.500/22, datë 07.10.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.